



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.607/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP) në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Hidajete Gashi Alaj kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e kandidatit për deputet nga radhët e Subjektit Politik, Nova Demokratska Stranka (NDS), Almir Veliji, me seli në Prizren, të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Komunën e Prizrenit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 26.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHEN TË PASAFATSHME ankesat A.nr.607/2025, A.nr.608/2025, A.nr.609/2025 dhe A.nr.610/2025, të datës 25/02/2025, të parashtruara nga kandidati për deputet nga subjekti politik Nova Demokratska Stranka (NDS), Almir Veliji, me seli në Prizren, paraqitur kundër Qendrës Komunale të Numërimit në Komunën e Prizrenit, për shkak të parregullsive gjatë numërimit, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë 25.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat A.nr.607/2025, A.nr.608/2025, A.nr.609/2025 dhe A.nr.610/2025, të parashtruara nga kandidati për deputet nga subjekti politik Nova Demokratska Stranka (NDS), Almir Veliji, me seli në Prizren.

Në ankesën A.nr.607/2025, theksohet se Almir Veliji kandidat për deputet ka kërkuar që të shikohen kamerat ku janë numëruar votat në Qendrën Sportive në Prizren, sepse sipas parashtruesit të ankesës vëzhguesit e tij, ku ka fotografuar, dhe nga rezultatet për kandidat po del që ai i ka 52 vota, kurse në rezultatet e publikuara nga ana e KQZ-së figurojnë 46. Si dhe ka kërkuar që në Shkollën Ekrem Rexha Vendvotimet 2022/01, 2022/02, 2022/03, 2022/04, 2022/05 të rinumërohen këto 5 vendvotime.

Në ankesën A.nr.608/2025, theksohet se Almir Veliji kandidat për deputet ka kërkuar që të rinumërohen votat, në Prizren në Shkollën 2003 Motrat Qiriaz, sepse sipas vëzhguesit të tij i ka 35 vota në këtë shkollë, kurse nga KQZ ai i ka 22, andaj ka kërkuar rinumërimin në këto vendvotime 2003/01, 2003/02, 2003/03, 2004/04, 2004/05, 2004/06, 2004/07, 2004/08, 2004/09, 2004/10 dhe 2004/11.

Në ankesën A.nr.609/2025, theksohet se Almir Veliji kandidat për deputet ka kërkuar që të rinumërohen votat në Prizren në Shkollën 2003 Motrat Qiriaz, sepse sipas vëzhguesit të tij i ka 35 vota në këtë shkollë, kurse nga KQZ unë i kam 22, andaj ka kërkuar rinumërimin në këto vendvotime 2003/01, 2003/02, 2003/03, 2004/04, 2004/05, 2004/06, 2004/07, 2004/08, 2004/09, 2004/10 dhe 2004/11.

Në ankesën A.nr.610/2025, theksohet se në numërimin e votave në vendvotimin 2004 Gjon Buzuku, në Prizren, kur janë numëruar votat e kandidatëve në Qendrën Sportive, votat e tij janë 29, kurse në publikim rezultatet nga ana e KQZ-së të publikuara janë 12 dhe ka kërkuar rinumërimin në këto vendvotime 2004/01, 2004/02, 2004/03, 2004/04, 2004/05, 2004/06, 2004/07 dhe 2004/08.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 26.02.2025, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), theksohet se bazuar në këtë fazë të procesit zgjedhor kur ankesa është dorëzuar në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), me pretendimet e ankuesit për mungesën e votave në vendvotimet e specifikuara në ankesë, nuk mund të procedohet si ankesë e afatshme. Se pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë dhe ankesa është e pasafatshme rezultojn fakti se në QKN, në komunën e Prizrenit, me datën 19.02.2025 në ora 17:20 është përmbyllur procesi i numërimit të votave të kandidatëve për deputetë dhe verifikimit të votave të subjekteve politike nga formularët e plotësuar në vendvotime më 9 shkurt 2025, në QKN në komunën e Prizren dhe i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, të përdorura për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 shkurt 2025, janë dorëzuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) e komunës së Prizrenit më datën 22.02.2025, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Po ashtu, pas shqyrtimit të deklaratës të vëzhguesit të bashkangjitura në ankesë, gjejmë se të njëjtat nuk janë të mjaftueshme për tu konkluduar se në QKN në Prizren, ankuesi ka pasur mungesë të votave dhe rrjedhimisht pretendimet ankimore, mbështeten në pohime të vëzhguesit të caktuar të cilat nuk janë argumentuar me asnjë dokument, por këto janë vetëm pretendime të supozuara. Gjithashtu, pretendimet se gjoja ankuesi është dëmtuar me vota në rezultatet nga KQZ-ja nuk qëndrojnë, sepse këto nuk janë shpallje të rezultateve përfundimtare, por këto janë forma të rezultateve të plotësuar në QKN nga ekipet e numërimit dhe të të interesuarit mund të shohin rezultatet e çdo vendvotimi duke shfletuar kopjet e formularëve me qëllim të rritjes së transparencës për procesin zgjedhor. Publikimi i formularëve nga QKN, sipas komunave ka qenë proces i vazhdueshëm, ku pas përfundimit të numërimit, formularët e plotësuar skanohen dhe të njëjtit publikohen gradualisht në ueb faqen e KQZ-së. Meqenëse në aspektin kohor-faza e procesit zgjedhor ku parashikohet ankesa është e pas afatshme për administrimin numërimit në QKN dhe parakohshme për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare, ankesa duhet të hedhet poshtë për të dy rastet.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si në vijim: A.nr.607/2025, A.nr.608/2025, A.nr.609/2025 dhe A.nr.610, të datës 25.02.2025 janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e

përbashkët A.nr.607/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga kandidati për deputet nga radhët e Subjektit Politik, Nova Demokratska Stranka (NDS), Almir Veliji, me seli në Prizren, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesat dhe përgjigjen në ankesë vlerësoi se :

- Ankesat janë të pasafatshme.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se kandidati për deputet nga radhët e Subjektit Politik, Nova Demokratska Stranka (NDS), Almir Veliji, me seli në Prizren, ka dorëzuar ankesat në PZAP, më datë 25.02.2025, ku ka theksuar se ka pranuar informata nga vëzhguesit se, pas numërimit të votave në (Qendrën Sportive në Prizren) dhe nga rezultatet për kandidat del që ai i ka 52 vota, kurse në rezultatet e publikuara nga ana e KQZ-së figurojnë 46. Ndërsa në shkollën Motrat Qiriaz, sipas vëzhguesit i ka 35 vota në këtë shkollë, kurse nga KQZ ai i ka 22. Po ashtu në numërimin e votave në vendvotimin 2004 Gjon Buzuku në Prizren, kur janë numëruar votat e kandidatëve në Qendrën Sportive, votat e tij janë 29, kurse rezultatet nga ana e KQZ-së të publikuara janë 12. Ankesa me numër A.nr.608/2025 ka pretendime të njëjta, gjendje të njëjtë faktike me ankesën e parashtruar A.nr.609/2025.

Megjithatë, ankesat janë parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesave, sipas nenit 105 paragrafi 1 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesave lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen, me shkrim pranë PZAP-së brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, ndërsa ankesat janë dorëzuar në PZAP më datë 25.02.2025, njëra në ora 14:17, ndërsa tri tjerat në ora 14:20, kurse nga hetimi i ndërmarr nga PZAP-i dhe nga përgjigja e KQZ-së, procesi i numërimit në QKN është përfunduar më datën 19.02.2025 në orën 17:20, që do të thotë se ankesat janë dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor. Ankesa me numër A.nr.608/2025 ka njëjtësi objektive, gjendje të njëjtë faktike me ankesën e parashtruar A.nr.609/2025.

Paneli, ka gjetur se ankesat e parashtruara nga kandidati për deputet nga radhët e Subjektit Politik Nova Demokratska Stranka (NDS), Almir Veliji, janë parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 105 paragrafi 1 i LZP-së, *ku afati për dorëzimin e ankesave lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen*, me shkrim pranë PZAP-së brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Paneli gjeti se të njëjtat janë ushtruar pas afatit ligjor, dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 105 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.5 të Rregullës 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr. 607/2025 më datën 26.02.2025

Kryesuesë e Panelit
Hidajete Gashi Alaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.